

Република Северна Македонија

Министерство за образование и наука



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Arsimit dhe Shkencës



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
СКОПЈЕ - SHKUP

Бр.№04-6203/1

- 8 -06- 2023 20 год./viđ

СКОПЈЕ - SHKUP

08-06- 2023

KODI ETIK

пër sjelljen e punonjësve në

Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

Shkup, qershor 2023

Në bazë të nenit 55 paragrafit (1) të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/2000, 44/2002, 82/2008, 167/2010 dhe 51/ 2011 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/2019 dhe 110/2019), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli.

**Kodin e etikës për sjelljen e punonjësve në**

**Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës**

**1,DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë kod Etikë (në tekstin e mëtejshëm) përcaktohen parimet themelore të etikës edhe atë mënyrën e sjelljes, veprimit dhe realizmit së detyrave profesionale të punonjësve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm Ministria) dhe persona të tjera të cilët kryejnë punë në Ministri me qëllim të sigurimit të:

- kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, profesionalizmit dhe integrititetit personal, moralit dhe standardet e larta, efikasitetitit efektivitetin, besnikërinë, përkushtimin dhe përgjegjësinë e shtuar gjatë realizimit të punës dhe detyrave të punës të punonjësve, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë realizimit të detyrave të punës në kuadër të Ligjeve dhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe përforcimin e integrititetit të Ministrisë dhe forcimin e besimit të qytetarëve në punën e tyre.

**1. PARIMET THEMELORE DHE STANDARDET PROFESIONALE**

**Neni 2**

- Punonjësit e Ministrisë gjatë realizimit të punëve dhe detyrave të punës udhëhiqen nga këto parime themelore
- ligjshmërinë, paanshmërinë, ekspertizën dhe profesionalizmin në veprim në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjet
- paanshmërinë dhe neutralitetinë politik
- realizimin e interesit publik
- veprimit sipas autorizimeve dhe statusit dhe përdorimin e funksionit të tij , autorizimin publik, detyrën zyrtare dhe pozitën për realizimin e çdo përfitimi përveten ose tjetrin.

- respektimin e ndërsjellë dhe mbrojtjen e reputacionit të Ministrisë
- shmangia e konfliktit të interesave, sjelljeve joetike dhe aktiviteteve të papranueshme të punonjësve në Ministri
- mbështetjen e të gjithë Ligjeve dhe Rregulloreve që parashikojnë mundësi dhe kushte të barabarta për të gjithë
- besueshmërinë e informacioneve zyrtare dhe respektimin e detyrave për mbajtjen e sekreteve afariste
- përdorimin efikas dhe ekonomik të mjeteve
- ndalimi i marrjes së dhuratave dhe përfitimeve nga persona të tjerë për veprim ose mosveprim në Ministri.
- Pamje profesionale e punonjësve

### **Parimi i ligjshmërisë, ekspertizës, profesionalizmit dhe paanshmërisë në punën**

#### **Neni 3**

Punonjësit e Ministrisë në realizimin e punëve dhe detyrave e respekojnë Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Punonjësit janë të obliguar të realizojnë punën e tyre me profesionalizëm dhe efikasitet me shfrytëzimin e njohurive dhe aftësitë e tyre më të mira, të ndjekin zhvillimin dhe të zbatojnë njohuritë e reja, të jenë të vetëdisiplinuar, si dhe të avansohen profesionalisht për shkak të përparimit personal dhe efikasitetit të Ministrisë.

Është moralisht e papranueshme mosrespektimi i standardeve të sjelljes profesionale, të cilët mund të shpien në dështim në punë, shkeljen e profesionalizmit, ekspertizës dhe efikasitetit. Punonjësit duhet të realizojnë punën dhe detyrat e tyre me vetëdije, ndërgjegje, përgjegjësi dhe ndershmëri me shumë kujdes. Punonjësit Vendimet i sjellin në mënyrë të paanshme dhe pa asnje ndikim të brendshëm apo të jashtëm vetëm në bazë të fakteve dhe rrethanave duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e nxënësve në procedurë.

### **Paanshmëria politike dhe neutraliteti**

#### **Neni 4**

Punonjësit punët dhe detyrat e punës i realizojnë në mënyrë politike neutrale. Punonjësit nuk i përfqësojnë ose nuk e shprehin lidhjen politike të tyre në realizimin e detyrave të punës dhe gjatë kontakteve zyrtare. Punonjësit nuk realizojnë aktivitete politike që mund të ndikojnë në besimin në aftësinë e tyre që t'i realizojnë detyrat e punës në mënyrë të paanshme dhe objektive. Punonjësit, si në marrëdhënet e tyre me punonjësit e tjerë të Ministrisë, ashtu edhe me personat e jashtëm që kryejn punë në Ministri, nuk duhet të përmenden, theksojnë apo tërthorazi të bëjnë të ditur përkatësinë e tyre politike ndaj një partie të caktuar politike. Punonjësit nuk do të ndërmarrin aktivitete që do t'i detyrojnë punonjësit e tjerë të Ministrisë që t'i bashkohen tek një partie të caktuar politike dhe as nuk do t'i inkurajojnë ata që ta bëjnë këtë duke i'u premtuar avancim në karrierë.

## **Realizimi i interesit publik**

### **Neni 5**

Punonjësit në punën e tyre i përkushtohen ekskluzivisht publikut interesit dhe të mirën e përgjithshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj. Punonjësit krijojnë marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi të ndërsjellë me qytetarët dhe personat juridikë, duke treguar mirëkuptim, mirësjellje dhe vullnet për të ndihmuar, ndërësa duke mos penguar realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre.

## **Shfrytëzimi i detyrës, autoritetit publik, detyrës zyrtare dhe pozitës për realizimin e përfitimit**

### **Neni 6**

Punonjësit në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës nuk duhet t'i shfrytëzojnë përparësitë përfitimi personale të cilat rrjedhin nga statusi i tyre as informacionet të cilat i kanë fituar gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare. Punonjësit nuk duhet të ofrojnë apo sigurojnë qfar do lloj përparsie në lidhje me statusin e tyre në ministri. Punonjësit nuk duhet me-vetëdije dhe qëllimisht të sjellin në hamendje publikun apo punonjësitë e tjerë të ministrisë. Punonjësit në komunikimin zyrtar apo privat me persona fizikë apo juridikë nuk duhet të krijojnë apo paraqesin pretendime të rreme në lidhje me pozitën, statusin dhe autoritetin e tyre zyrtar. Punonjësi nuk lejohet të shfrytëzojë vendin e punës dhe funksionin për qëllime private dhe përfitimi personale ose përfitimi për të afërmit e tij, miqtë, organizatat dhe kompanitë ku ai kërkon punësim, madje edhe në rastet kur sjellja e tillë nuk do t'i shkaktojë asnje dëm institucionit. Punonjësi nuk duhet të përdorë në mënyrë të papërshtatshme autoritetin, të kërkojë, inkurajojë, detyrojë ose udhëzojë punonjës tjetër që të kryejë aktivitete të tjera në vendin e punës, përveç aktivitetave të cilët janë të domozdoshme për kryerjen e detyrave zyrtare ose për të cilat janë të autoizuar me Ligj dhe dispozitave të tjera pozitive.

## **Respektim reciprok dhe mbrojtje të reputacionit të ministrisë**

### **Neni 7**

Punonjësit nuk do të angazhohen në çfardo llojë aktivitete që janë në kundërshtim me kryerjen e detyrave të tyre zyrtare në përputhje me rregulloret pozitive dhe do të bëjnë gjithçka për të shmangur situatat, sjelljet dhe kontaktet me qytetarët që mund të dëmtojnë interesin, reputacionin dhe integritetin e Ministrisë.

Punonjësit sillen në mënyrë profesionale dhe ruajnë standardet më të larta të sjelljes, gjegjësisht sillen me vëmendje dhe respekt të veçantë për personalitetin dhe reputacionin e çdo individi, me të cilën kontribuon për ruajtjen dhe avancimin e besimit publik në integritet, paanshmérinë dhe efikasitetin e Ministrisë.

## **Shmangia e konfliktit të interesit, sjelljeve joetike dhe aktivitetave të papranueshme të punonjësve në ministri**

### **Neni 8**

Punonjësit, në kryerjen e kompetencave dhe detyrave të tyre, shmangin çdo konflikt ndërmjet interesit publik dhe interesit privat, gjegjësisht sjellin gjendje dyshimi për ekzistencën e konflikt interesit.

Punonjësit në kryerjen e detyrave veçanërisht udhëheqin llogari për respektimin e Kushtetutës, Ligji për Parandalimin e Korruptionit dhe Konfliktit të Interesit dhe Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve dhe Rregulloret Tjera dhe sigurimin e mekanizmave për respektimin e tyre nga të gjithë punonjësit e Ministrisë. Punonjësit në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare gjithmonë duhet të veprojnë në shërbim të interesit publik, duke përjashtuar interesat e tyre private, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, konfidencialitetit, pavarësisë, pavarësisë, ndershmërisë dhe profesionalizmit.

## **Respektimi i të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që parashikojnë të barabartë mundësi dhe kushte për të gjithë**

### **Neni 9**

Punonjësi do të mbështeten te të gjitha Ligjet dhe rregulloret që parashikojnë mundësi dhe kushte të barabarta për të gjithë në aspektin material dhe jomaterial, pa dallim nga raca, ngjyra e lëkurës, feja, gjinia, origjina etnike, mosha apo vështirësit si hendikep.

## **Konfidencialiteti i informimit zyrtar dhe respektimi i detyrimeve përmajtjen e sekreteve afariste**

### **Neni 10**

Punonjësit janë të detyruar të kujdesen për sigurinë dhe konfidencialitetin e të gjitha informatave dhe dokumenteve që rrjedhin nga puna në ministri. Punonjësi nuk mund pa autorizim dhe përmajtje të paautorizuara të shfrytëzojë ose të japë asnjë informatë. Ndalohet publikimi në çfarëdo mënyre informacioni në të cilin punonjësi ka qasje në kryerjen e punëve dhe detyrave zyrtare, llojet dhe mënyrat e punës ose çdo informate tjetër konfidencial. Edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, pozicionit ose angazhimit, punonjësit nuk mund t'i publikojnë informatat dhe të dhëna personave që nuk janë të autorizuar.

## **Përdorimi efikas dhe ekonomik i mjeteve**

### **Neni 11**

Punonjësit sigurojnë efikasitet maksimal dhe administrim dhe shfrytëzim ekonomik të pasurive materiale, pajisjeve dhe objekteve që u janë besuar në kryerjen e detyrave të punës dhe parandalojnë përdorimin dhe asgjësimin e paligjshëm të tyre. Punonjësit marrin masat

e duhura për sigurinë e lëndëve të besuara dhe për eleminimin e mundësisë e shkaktimit të dëmit material në Ministri. Punonjësit nuk i përdorin për qëllime private mjetet, objektet apo pajisjet që u janë besuar në përdorim dhe disponim në Ministri.

### **Ndalimi i marrjes së dhuratave dhe përfitimeve nga persona të tjerë për veprim apo mosveprimi në ministri**

#### **Neni 12**

Punonjësit e Ministri nuk mund të kërkojnë ose të pranojnë, gjegjësisht të lejojnë person tjetër në emër të tyre ose për interes të tij llogari të kërkojë ose të marrë përfitime, shpërblime, kompensime ose dhurata nga çfarëdo burimi, pavarësisht nëse ato janë në formë financiare apo jo financiare.

Punonjësit i ndalohet, në lidhje me punën që kryen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në emër të tij dhe të tjetër (për anëtarët e familjes së tij, të afërmit dhe miqtë e tij, etj.), të kërkojë ose të marrë dhurata, shpërblime, kompensime, pretime, shërbime ose përfitime të tjera, që kanë karakter korruptiv dhe që mund të ndikojnë në sjelljen e Aktvendimit dhe vendimit ose të prishin marrëdhëniet e tij profesionale. Punonjësi nuk guxon të përdorë pozitën ose autoritetin e tij zyrtar duke u dhënë privilegjë personave të tretë për kompensim dhe në kundërshtim me pavarësinë, ndershmërinë dhe dinjitetin profesional, do t'i përdorë për realizimin e përfitimit pronësor për vete dhe dikë tjetër ose tjetrit, do t'i shkaktojë dëme të caktuara. Punonjësi që vihet në pozitën për t'iu ofruar dhuratë ose përfitim tjetër të kompensuar drejtpërdrejt me aktivitetet që ai i kryen në vendin e duhur, është i detyruar të refuzojë një ofertë të tillë dhe pa vonesë t'ia raportojë mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejtë. Punonjësit nuk duhet të ofrojnë ose të japid përfitime, shpërblime, kompensime ose dhurata për palët me qëllim menjanimin e benefiteve të caktuar për veten, familjen, miqtë, shoqatat ose partinë e tyre politike të përfitimit të palejuar, shpërblimit, kompensimit ose dhuratës së paligjshme shkelje e dispozitat e këtij kodeksi, i cili parashikon përgjegjësinë disiplinore.

### **Paraqitura profesionale e punonjësve**

#### **Neni 13**

Stili i veshjes dhe pamja e jashtme e çdo punonjësi ka ndikim jo vetëm në reputacionin e institucionit, por më e rëndësishmja në perceptimin publik të punonjësve të Ministrisë.

Punonjësi me pamjen e tij duhet të tregojë profesionalizëm dhe rregull. Punonjësi është i detyruar të vijë në punë i pastër, i rregullt, i pushuar dhe i veshur mirë, gjë që nënkupton se rrobat duhet të jenë të zgjedhura në mënyrë të tillë, me ngjyrën/modelin dhe prerjen të mos tërheqin vëmendje të veçantë. Rrobat afariste përfshijnë kostum afarist, fustan, fund të shkurtër deri te gjunjët, pantallona, bluzë, këmishë, xhaketë. Rrobat afariste përfshijnë kostum, pantallona, xhaketë, këmishë, bluzë. Bizhuteritë, tualetet, flokët dhe grimi duhet të zgjidhen në mënyrë që të përcjellin mirësjellje dhe rregullsi dhe të përshtaten me pamjen afariste.

## Zbatimi i dispozitave të kodit të etikës

### Neni 14

Çdo punonjës duhet të respektojë të gjitha dispozitat e kodit, duke filluar nga udhëheqësit të cilët me sjelljen e tyre personale duhet të jepin shembull përmenyrën e veprimit dhe respektimit të parimeve etike të punonjësve të Ministrisë.

### 3. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Ky kod hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

Министер за образование и наука,

Ministér i Arsimit dhe Shkencës,

Doc. Dr. Jeton Shaqiri

